

## MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Suela Zhegu, në përbërje të trupit gjykues, me cilësinë e relatores së çështjes, për subjektin e rivlerësimit Ardian Braho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, konkluzion ky i bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Në mbështetje të qëndrimit kundër, po argumentoj në vijim arsyet mbi të cilat kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, të cilat në përfundim më kanë çuar në vlerësimin se subjekti i rivlerësimit duhet të ishte konfirmuar në detyrë.

### **Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

**Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasuritë e personit të lidhur**, në përputhje me pikën 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku për periudhën e rivlerësimit, babai dhe çdo person i përmendur në certifikatën familjare, cilësohet si i tillë, si vijon:

**1. Apartament banimi me sip. 91m<sup>2</sup>**, i blerë nga babai në shumën 3.300.000 lekë, në rrugën “A.L”, ish-Fusha e Aviacionit, Tiranë. Nisur nga analiza e fakteve dhe provave të administruara në dosje, u konstatua se: pasuria është deklaruar saktë; pasuria është blerë përpara se subjekti i rivlerësimit të emërohej në detyrën e prokurorit; prindërit dhe subjekti nuk kanë qenë të detyruar të ishin të kujdesshëm për ruajtjen e dokumentacionit mbi të ardhurat e tyre nga punësimi në sektorë privatë apo mbi të ardhurat si emigrant në shtetin grek, apo të ishin të kujdesshëm lidhur me çmimin e shitjes së apartamentit në Shkodër;

duke arritur në konkluzionin se pamjaftueshmëria financiare e rezultuar nga analiza e kryer nga Komisioni, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, në bazë të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

✓ Ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën e trupit gjykues.

**2. Apartament banimi me sip. 50 m<sup>2</sup>**, i blerë nga babai në shumën 3.300.000 lekë në vitin 2007, në rrugën “A.L”, ish-Fusha e Aviacionit, Tiranë, me vlerë 3.000.000 lekë, apartament ky ngjitur me apartamentin ekzistues, ku subjekti ka banuar së bashku me prindërit.

Si burimi i krijimit në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga paga në funksionin e prokurorit; (ii) të ardhurat nga babai nga pensioni i parakohshëm, pensioni suplementar dhe pensioni i pleqërisë, si dhe të ardhurat e përfituara nga punësimi në sektor privat; (iii) të ardhura nga nëna nga pensioni i pleqërisë, si dhe nga punësimi i saj në sektorin privat.

### **2.1 Analiza e fakteve të dala gjatë hetimit:**

- i. Referuar akteve ligjore, apartamenti rezulton në pronësi të babait të subjektit.
- ii. Ka rezultuar se subjekti ka banuar gjatë gjithë kohës me prindërit, sipas deklarimeve vjetore dhe deklaratës *Vetting*.
- iii. Në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka deklaruar në bashkëpronësi këtë pasuri të babait, për faktin se ka kontribuar për blerjen e tij.
- iv. Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit se në vitin 2005 është martuar, në vitin 2006 familja shtohet me një fëmijë dhe në vitin 2007 kanë shtuar hapësirën e banimit me sip. 50 m<sup>2</sup>, duke blerë apartamentin e fqinjës ngjitur, me çmimin 3.000.000 lekë.

- v. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga paga e prokurorit, të ardhurat e prindërve nga pensionet dhe punësimet e tyre në sektorë privatë.
- vi. Nga analizimi i likuiditeteve në llogaritë bankare evidentohet fakti se në llogarinë e pagës subjekti ka mbajtur kursimet e tij nga viti 2005, të cilat i ka tërhequr 3 ditë para blerjes së apartamentit në vitin 2007, në shumën 1.650.000 lekë. Gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar se i ka përdorur këto shuma për blerjen e apartamentit.
- vii. I pyetur mbi mundësitë e babait për të blerë këtë apartament në vitin 2007, në vlerën 3.000.000 lekë, subjektit ka deklaruar se janë përdorur kursimet e tij në shumën 1.650.000 lekë të mbajtura në llogarinë e tij bankare, si dhe kursimet e babait në shumën 20.000 euro, të tërhequra nga llogaria e tij bankare para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.

## 2.2 Analiza financiare për blerjen e apartamentit

Si anëtare në pakicë, çmoj se analiza financiare mbi burimet e ligjshme për blerjen e pasurisë apartament e kryer nga shumica, nuk është në përputhje me faktet dhe rrethanat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe me vetë deklarimet e subjektit në deklaratën *Vetting*, ku kam vlerësuar të analizohen të ardhurat e ligjshme familjare duke përdorur metodën kumulative, për periudhën 2001 – gusht 2007, për arsyet si vijojnë: (i) referuar akteve ligjore, apartamenti është blerë nga babai dhe në pronësi të tij; (ii) subjekti provohet të ketë banuar se bashku me prindërit; (iii) subjekti ka deklaruar se është kontribuues në këtë pasuri për faktin se gjatë gjithë kohës ka jetuar me prindërit si një familje dhe të ardhurat e tyre familjare janë menaxhuar nga babai si kryefamiljar; (iv) prindërit e subjektit nuk kanë qenë subjekte deklarues dhe, për rrjedhojë, në deklarimet periodike vjetore subjekti nuk ka pasur detyrim të deklarojë të ardhurat e tyre nga punësimi në sektorë privatë, shpenzimet, si dhe kursimet e tyre vjetore.

Nisur nga këto fakte dhe rrethana, u analizuan të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe prindërve, duke mos përfshirë të ardhurat e prindërve nga punësimi në sektorë privatë, të cilat nuk rezultuan të ligjshme në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, sipas tabelës vijuese.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 2001 - gusht 2007</b>
Të ardhura nga pensionet e prindërve	1 553 219
Të ardhura nga pagat e subjektit	5 749 197
Të ardhura nga interesat e depozitës	16 927
<b>Të ardhura totale</b>	<b>7 319 342</b>
Apartamenti	3 000 000
Likuiditete në bankë	113 949
Automjet	250 000
<b>Pasuri</b>	<b>3 363 949</b>
Shpenzime jetese	2 510 856
Shpenzime udhëtimi	208 470
Shpenzime mobilimi	230 000
<b>Shpenzime totale</b>	<b>2 949 326</b>
<b>Rezultati financiar</b>	<b>1 006 067</b>

**2.3** Nga analiza e kryer ka rezultuar se ka mjaftueshëm burime të ligjshme për blerjen e apartamentit në vitin 2007, në shumën 3.000.000 lekë, duke konkluduar përfundimisht se pasuria është deklaruar saktë në përputhje me ligjin 84/2016, si dhe u provua bindshëm burimi i ligjshëm për krijimin e pasurisë në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**3. Depozita në vlerën 20.000 euro, në datën 7.5.2007, në emër të babait të subjektit, në BKT dhe tërhequr cash në datën 13.8.2007, disa ditë para blerjes së apartamentit.**

Në prapësime, subjekti ka shpjeguar qartë se: *“Personi që ka çelur llogarinë bankare, babai, në datën 7.5.2007 dhe e ka mbyllur në datën 13.8.2007, nuk ka pasur detyrimin për t’i deklaruar faktet e mësipërme, si në cilësinë e subjektit deklarues ashtu edhe në cilësinë e personit të lidhur, në deklaratat periodike”*.

Nisur nga logjika e fakteve të dala gjatë hetimit, sa më sipër kam cituar në pikën 2.3, si anëtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm dhe ka provuar se të ardhurat e tij dhe të prindërve kanë qenë të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume.

Nga analizimi i të ardhurave të ligjshme të subjektit dhe të prindërve, duke filluar nga viti 2001 dhe deri në momentin që këto kursime janë depozituar në llogarinë bankare në maj të vitit 2007, ka rezultuar se babai i subjektit ka pasur mundësi për të krijuar këtë shumë, pa përfshirë të ardhurat e prindërve të subjektit nga punësimi i tyre në sektorë privatë.

**4. Depozitë në emër të babait në BKT, çelur në datën 30.7.2014, në shumën 12.980 euro,** nga analiza e kryer ka rezultuar pamjaftueshmëri financiare për kursimet *cash*, të shtrirë në dy vite, për vitet 2012 dhe 2013, në shumën totale 577.176 lekë.

(ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën e trupit gjykues).

**5. Lidhur me transfertat bankare të dërguara nga tezja e subjektit, në llogari të babait të subjektit**

Si anëtare në pakicë kam vlerësuar faktin që këto shuma të dërguara nga tezja në vitet 2003 – 2005, nëpërmjet sistemit bankar apo *cash*, nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk kanë rezultuar të jenë përdorur nga personi i lidhur (babai i subjektit) dhe as të kenë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie, as si përfitim në formë “dhurate”. Këto transaksione u hetuan gjerësisht nga Komisioni, si dhe subjektit iu kërkua dokumentacion mbi burimet e ligjshme të tyre.

Subjekti, në prapësime e tij, ka pretenduar se nuk është marrë në konsideratë mundësia e kursimit të tezes Z. A dhe bashkëshortit Z.A, për periudhën 1993 – 1998, për të cilat ndodhet në pamundësi objektive për të siguruar dhe provuar me dokumentacion këto të ardhura. Gjithashtu, subjekti pretendoi se Komisioni duhet të korrigjojë shpenzimet jetike, për periudhën 1999 – 2005, duke ulur për 3 vjet shpenzimet jetike për një person, pasi tezja nuk e ka pasur në ngarkim njërin prej djemve të saj në periudhën 1999 – 2001.

Për sa i takon pamundësisë objektive të subjektit për të siguruar dokumentacion mbi mundësinë e krijimit të kursimeve nga tezja në vitet 1993 – 1998, duket se jemi në një nga kushtet e parashikuara në nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016, nisur nga faktet se:

- Tezja e subjektit dhe familjarët e saj nuk e gëzonin statusin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk kishin ndonjë detyrim ligjor të tregoheshin të kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit, që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tyre të shtrira në kohë.
- Koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura, e bën të vështirë edhe vetë ruajtjen e dokumentacionit që mund të sillte edhe më tepër informacion në këtë drejtim.
- Këto vlera monetare nuk janë përdorur nga subjekti si burim për krijimin e ndonjë pasurie të luajtshme apo paluajtshme.

**Analiza financiare**, e rishikuar pas prapësimeve, pas korigjimit të shpenzimeve jetike paraqitet si vijon.

Përshkrimi	Periudha 1999 – 2005/ vlerat në USD
Total të ardhura <i>neto</i> Z dhe Z. Agolli	182 903
Shpenzime jetese për 4 persona	113 066
<b>Të ardhura minus shpenzime</b>	53 685
<b>Shuma të dërguara babait të subjektit</b>	78 560
<b>Mundësi për të dërguar para</b>	<b>- 8 723</b>

Nga analiza e rishikuar mbi mundësitë e tezes së subjektit për të dërguar paratë, pas reduktimit të shpenzimeve jetike në SHBA, rezulton me një balancë negative në shumën 8.723 USD.

#### **Vlerësimi i anëtarit në pakicë**

Marrëdhënia e prindërve me tezen e subjektit është një marrëdhënie e posaçme për shkak të lidhjes së afërt familjare dhe lidhur me shumat (në dollarë) të dërguara nga SHBA-ja, apo transfertë bankare, apo *cash*, të mbajtura në llogarinë e babait të subjektit, fakte këto të dala nga verifikimi i llogarive bankare të babai, me të drejtë, Komisioni ngriti dyshimin e arsyeshëm mbi burimet e ligjshme të parave të dërguara, si dhe dyshimin për destinacionin e këtyre shumave dhe në rezultate të hetimit i kaloi subjektit barrën e provës.

- ✓ Pas prapësimeve, subjekti arriti të provojë burimet e ligjshme të krijimit në një shumë të konsiderueshme të ardhurash prej 182.903 USD, me burim krijimi të ardhurat e biznesit privat të tezes dhe bashkëshortit të saj, të cilët operonin në fushën e ndërtimit në SHBA.

Bazuar në provat e administruara në dosje, duke analizuar në tërësi faktet dhe rrethanat e dala gjatë hetimit si:

- transfertat bankare të ardhura nga llogaria e tezes në llogarinë e babait të subjektit janë kryer në periudhën 2003 – 2005, në më të shumtën e tyre nëpërmjet sistemit bankar;
- subjekti provoi në fund të procesit burimin e ligjshëm në një masë të konsiderueshme, sipas tabelës sa më sipër;
- këto shuma nuk e afektojnë krijimin e pasurive të subjektit apo të personit të lidhur;
- dy depozitime *cash* të shumave korrespondojnë me qëndrimin e tezes në Shqipëri për rreth 1 muaj;
- këto para nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie, apo të jenë deklaruar si huamarrje apo dhurim;

- gjatë hetimit nuk u konfirmua ndonjë interes pasuror i subjektit apo personit të lidhur me të;
  - në kohën e krijimit të të ardhurave nga tezja dhe familjarë të saj, tezja dhe babai i subjektit nuk gëzonin statusin e personave të tjerë të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk kishin ndonjë detyrim ligjor për t'u treguar të kujdesshëm në ruajtjen e dokumentacionit mbi të ardhurat e ligjshme të tyre në atë kohë; si dhe
  - nisur nga koha e largët e krijimit të të ardhura, për më shumë se 15 vjet.
- ✓ Në analizim të fakteve sa më sipër, konkludoj se është përtej çdo dyshimi që këto shuma të lidhen me funksionin e subjektit dhe të vijnë nga burime të paligjshme. Në këtë rast, merr një rëndësi fakti që subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore, mbi një situatë të paparashikuar ligjore, të pabazuar në ligjin nr. 84/2016, e cila do të ngarkonte subjektin me një barrë përtej asaj që ligjërisht është ngarkuar të mbajë.

## II. PASURITË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

**1. Automjet tip “Mercedes-Benz”, çmimi 12.000 euro, blerë në vitin 2011, nga analizimi i burimeve të ligjshme ka rezultuar pamjaftueshmëri në shumën 471.642 lekë (ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën).**

**2. Kursime *cash* në vitin 2015, nga analiza financiare ka rezultuar një balancë negative në shumën 324.395 lekë.**

Pas prapësimeve, duke pranuar shpjegimet e subjektit, në lidhje me uljen e shpenzimeve jetike për vajzën, pasi pagesa e shkollës përfshin vaktet ushqimore të cilat konsumohen në shkollë, pra, nisur nga fakti që pagesa e shkollimit përmban dhe një pjesë të shpenzimeve për ushqim të fëmijës, duke u reflektuar në analizën financiare, balanca negative për vitin 2015, pas prapësimeve do rezultonte në shumën 257.122 lekë.

### **3. Shpenzimet jetike për vitin 2008**

Subjekti, në prapësime, ka evidentuar në analizën financiare shpenzime të dubluara, si shpenzimet për ditët e qëndrimit në Greqi, për kurim shëndetësor gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2008, pasi në shpenzimet e kurimit janë përfshirë edhe shpenzimet jetike të asaj periudhe. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ka pasur vizita nga të afërm, miq dhe kolegë të cilët kanë kontribuar në shuma të vogla.

- ✓ Pas prapësimeve, pas rishikimit të analizës financiare, duke ulur shpenzimet jetike të dubluara, për ditët e qëndrimit të subjektit dhe bashkëshortes në Greqi, për arsye shëndetësore, balanca negative është në vlera minimaliste (81.901 lekë), duke i vlerësuar shpjegimet e subjektit të pranueshme në varësi me rrethanën faktike.
- ✓ **Analiza financiare përmbledhëse për periudhën nga 2003 – 2016**

---

Në vitin 2011, për blerjen e automjetit balancë negative	në vlerën 471.642 lekë
Kursime për vitin 2012 balancë negative	në vlerën 386.401 lekë
Kursime për vitin 2013 balancë negative	në vlerën 190.774 lekë
Kursimet <i>cash</i> për vitin 2015 balanca negative	në vlerën 257.122 lekë

---

në total në vlerën - 1305 939 lekë.

### **Vlerësimi për kriterin e pasurisë**

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë prej tij. Pas verifikimit, deklaramet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme, të sakta dhe në përputhje me ligjin 84/2016.

Balancat negative të shtrira në disa vite, të rezultuara nga analiza financiare e pasurive dhe e shpenzimeve, të cilat më së shumti lidhen me “personin e lidhur” babain e subjektit, bazuar në analizën e përditësuar financiare, nuk është i një shkalle të tillë që të cenojë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe as nuk ngrenë dyshime mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit. Për këto arsye, vlerësoj se mungesa e këtij likuiditeti e shtrirë në vite, nuk përbën arsye për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra. Vetë natyra e analizës financiare mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementët që vlerëson, ajo thjesht, shërben si një tregues i të ardhurave të ligjshme, pasurive dhe shpenzimeve të jetesës për një periudhë kohe.

### **Vlerësimi përfundimtar**

Mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që disponohen, si dhe në prapësimet e subjektit të rivlerësimit, me cilësinë e relatores në këtë çështje, e mbetur në pakicë, përfundimisht çmoj se duke u bazuar në tri kriteret e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit Ardian Braho ka plotësuar së bashku, kushtet e parashikuara në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Bazuar në konkluzionet e mësipërme, shumica e trupit gjykues, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duhej të dispononte konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ardian Braho.

**Suela ZHEGU**

**Anëtare/Kundër**